



Tirane, me 06.09.2021

VENDIMI NR. 5

Ne përfundim të mbledhjes Këshilli i Drejtimit morri vendimet e mëposhtme:

1. Miratohen Pasqyrat Financiare të vitit 2020 nga anëtarët e Këshillit të Drejtimit me këto ndryshime. Kuotat të ndahen sipas viteve me shënime shpjeguese në PF të vitit 2020 dhe të pasqyrohen si hyrje fondesh.
2. Miratohet buxheti 8 mujorin për vitin 2021, ku të përcaktohen kriteret e buxhetit (vjetor, 10 mujor dhe parashikimet).
3. Të behet regjistrimi i anëtarëve si KM për vitin 2021 nga Komiteti i Regjistrimit të cilët kanë plotësuar kërkesat ligjore dhe statutore për regjistrim.
4. Raporti i Komitetit të Auditimit do të dërgohet në Asamblenë e Përgjithshme me disa ndryshime:
 - a. Të behet analize afatshkurtër ose afatgjatë për përdorimin e cash-it.
 - b. Të behet një krahasim i PF dhe buxhetit për pesë vitet e fundit.
5. Miratohet programi dhe kalendari i përgatitur nga Komiteti i Kontrollit të Cilësisë për kontrollet që do të organizohen në vitin 2021 me këto detyra:
 - a. Të zgjidhen kontrolloret deri me datë 15 Shtator 2021.
 - b. Kontrolloreve t'u kompensohet shpenzimi i karburantit duke llogaritur rrugën që do të bëjnë në rrethë.
6. Miratohet programi dhe kalendari i EDV për 6 mujorin e dytë të vitit 2021, i propozuar nga KEKP ku janë të përcaktuara temat e trajnimeve të EDV, datat dhe orari i trajnimeve bashkë me lektoret.
7. Katër ore të jenë trajnim nga BMP për kuadrin rregullator të profesionit.
8. Trajnimet për EDV të jenë 10 ore me pagesë dhe 10 ore falas.
9. Të hartohet kalendari i mbledhjeve të degëve dhe seksioneve për zgjedhjen e kryesive të tyre si dhe përfaqësuesve në Asamblenë e Përgjithshme.
10. Data e zhvillimit të Asamblesë së Përgjithshme të jetë në muajin Nëntor 2021.



11. Mbas përcaktimit të kalendarit të mbledhjeve dhe datave të trajnimeve do të bëhen dhe takimi me kryetaret e degëve dhe seksioneve në të cilën do të diskutohen vendimet e KD për organizimin e zgjedhjeve në dege dhe seksione, organizimin i trajnimeve për EDV dhe hyrjen në profesion.

Këshilli i Drejtimit

Prof. Dr. Sotiraq Dhamo – Kryetar i Këshillit të Drejtimit

Prof. Dr. Ingrid Shuli – Anëtar i Këshillit të Drejtimit

Dr. Julian Naqellari – Anëtar i Këshillit të Drejtimit

Aqif Toska – Anëtar i Këshillit të Drejtimit

Era Halili – Anëtar i Këshillit të Drejtimit